



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.389/2023

Datë: 31 gusht 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në mbledhjen 314-të, të mbajtur me datë 31 gusht 2023, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për administrator në Gjykatën Supreme të Kosovës, në përbërjen si në vijim:
  1. Avni Mehmeti, anëtar i KGJK-së/kryetar i komisionit;
  2. Zenel Leku, gjyqtar në Gjykatën Supreme/anëtar i komisionit;
  3. Nora Bllaca-Dula, gjyqtare në Gjykatën e Apelit/ anëtare e komisionit;
  4. Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së/ anëtar rezervë i komisionit;
  5. Lirije Maksutaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare rezervë e komisionit.
- II. Komisioni ka mbështetje administrative dhe profesionale nga Njësia për Inspektim Gjyqësor.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 31 gusht 2023.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 31 gusht ka shpallur konkursin e brendshëm për administrator në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe ka themeluar komisionin për rekrutim.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi, Këshilli në këtë takim ka themeluar edhe komisionin për rishqyrtim, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve ndaj vendimeve të komisionit për rekrutim, konform nenit 6 të Rregullores nr. 04/2022 për Procedurën e

Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Qerim Ademaj

Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Anëtarëve të Komisionit;
- Njësisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.